



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj):

4.1 “Për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

4.2 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10¹ dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

¹ Fillimisht u trajtuan tre çështjet e para të rendit të ditës vetëm në prezencën e anëtarëve të Këshillit, nga ora 10:10 – 10:35, për të rifilluar mbledhja në platformën “online” në orën 10:55.

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Fatmira Luli*, për shkak të heqjes dorë më herët në marrjen pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
2. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj):

4.1 “Për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

4.2 “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po vijojmë mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 6 prill 2022.

Siç jeni në dijëni, në rendin e ditës së sotshme janë 13 çështje. Nga ana e Këshillit janë marrë në shqyrtim 3 çështje me dyer të mbyllura, për shkak të informacionit të klasifikuar që përmbajnë këto çështje.

Gjithashtu, dëshiroj t'ju sjell në vëmendje që në rendin e ditës, përveç çështjes për caktimin e një anëtari për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, të përfshijmë edhe çështjen për shqyrtimin e një projektvendimi që ka të bëjë me ndryshimin e vendimit të Këshillit, të marrë më 06.07.2021, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e udhëzuesit standard të shtypit", vendim ku në përbërjen e grupit të punës ka qenë anëtari i Këshillit, i cili ishte caktuar nga Këshilli për të kryer detyrat në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

A jeni dakord që ta përfshijmë?

Ilir Rusi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Ridvan Hado: Ok, Ridvani!

Marçela Shehu: Të filloj me renditjen...

Naureda Llagami: Jo, Marçela, hodha në votim që të shtojmë në rendin e ditës edhe projektvendimin që ka të bëjë me ndryshimin e vendimit "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin...".

Ne e kaluam në mbledhjen tonë (bëhet fjalë për mbledhjen që u bë vetëm në prezencën e anëtarëve), puna është që ta kalojmë edhe këtu.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, po e shtojmë në rendin e ditës.

Kalojmë tek çështja e parë, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë

11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithashtu edhe propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit, z. Dritan Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit, Kryetare!

Si pjesë e Komisionit të Karrierës, kemi bërë mbledhjen më datë 29 mars 2021 dhe kemi përgatitur edhe relacionin për renditjen e kandidatëve që konkurrojnë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

(Lexohet relacioni nga z. Hallunaj.)

“Pas plotësimit të kuadrit ligjor që mundësonte realizimin e procedurave ligjore të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në kushtet kur në Gjykatën e Lartë ishin krijuar disa pozicione të lira për shkak të mbarimit të mandatit të disa gjyqtarëve, apo shkarkimit nga detyra të disa të tjerëve si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fillimisht, Këshilli i Lartë Gjyqësor shpalli hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër to edhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.

Konkretisht, me Vendimin nr.172, datë 11.9.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 3/c dhe 5, të nenit 48 dhe nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në pikën 1, të nenit 31, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

I. Shpalljen e procedurës së emërimin në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile.

II. Afati i kandidimit

1. Afati i kandidimit është dy javë nga dita e publikimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brenda afatit dyjavor nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përcaktuar në vendimin si më lart, kanë shprehur interes dhe kanë aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për pozicionin e shpallur në fushën e të drejtës civile kandidatët si vijon: 1. Znj. {...}; 2. Z. {...}; 3. Znj. {...}; 4. Z. {...}; 5. {...}; 6. Znj. {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, me Vendimin nr. 182, datë 02.10.2019, bazuar në nenin 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, që kanë aplikuar për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019”. Po me këtë vendim, pas shortit të hedhur, është caktuar relatori përkatës për procedurat e verifikimit për kandidatin {...}. Dhe me anë të pikës 3, është përcaktuar se: “Për kandidatët znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe z. {...}, të cilët kanë aplikuar për pozicionet e shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.” Sipas pikës 4, është vendosur: “Mosfillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, për kandidaten znj. {...}, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.”

Procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë kanë përfunduar me vendim të formës së prerë për të gjithë kandidatët, konkretisht si vijon:

1. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të

“përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”, përcaktuar në nenin 136, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Z. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të “nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Znj. {...} është skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të mosplotësimit të kriterit të kandidimit, atij të “moskalimit të procesit të verifikimit të pasurisë”, përcaktuar në nenin 49, pika 5 në lidhje me nenin 32 pika 4 shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4. Z. {...} është kualifikuar në procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit.

5. Z. {...} është kualifikuar në procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, për shkak të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve të kandidimit.

6. Për Znj. {...}, me vendimin nr. 182, datë 02.10.2019 është vendosur mosfillimi i procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, në kushtet e tërheqjes së saj nga kandidimi më datë 30.09.2019.

Nga 6 (gjashtë) kandidatë që kanë konkurruar për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dy prej tyre, konkretisht z. {...} dhe z. {...}, janë kualifikuar për të vijuar procedurën e përzgjedhjes për emërim. Rezulton se për kandidatin z. {...}, me vendimin nr. 111, datë 27.02.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}”

Si i tillë, kandidati i vetëm i mbetur në garë për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019 është z. {...}.

Plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit nga kandidati i kualifikuar:

Referuar Vendimit nr. 560, datë 13.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka verifikuar plotësimin e kushteve dhe kriteret e kandidimit nga kandidati z. {...}. Në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për emërim në Gjykatën e Lartë për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin e sipërcituar, ka vendosur: “Kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. {...} dhe vijimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Në këto pika të kësaj dispozite përcaktohet se:

“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kriteret e tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.”

Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 49

(“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Në këto pika të kësaj dispozite përcaktohet se:

“1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i këtyre kushteve të kandidimit/emërimit:

a) qenia jurist – Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njëzuar me origjinalin) kopjen, në gjuhën angleze, të dokumentit “Diplomë” nr. {...}, datë 03.02.2004, lëshuar nga Universiteti {...}, sipas të cilit kandidati {...} i është dhënë titulli “Jurist”. Po ashtu, kandidati ka depozituar një Dokument Nr. Regjistri {...}, Datë 22.02.2005, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, sipas të cilit: “Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.523, datë 01.08.2003 “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta të huaja”, Komisioni i ngritur me Urdhrin nr. {...}, datë 15.12.2004 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në mbledhjen e datës 11.02.2005, mbasi ka shqyrtuar dokumentet e z.{...}, “Njohjen e kopjes së diplomës me nr. {...} prot., datë 03.02.2004 me titullin “Jurist”, lëshuar nga Universiteti i {...}”. Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar (të njëzuar me origjinalin) edhe kopjen, në gjuhën angleze, të dokumentit “Diplomë e Studimeve Pasuniversitare” nr. {...}, datë 29.11.2005, lëshuar nga Universiteti {...}, sipas të cilit kandidati {...} është diplomuar për studime pasuniversitare, në Programin e Studimeve të Evropës Juglindore. Po ashtu, kandidati ka depozituar edhe Dokumentin “Dëshmi për njohjen e diplomimit” Nr. Regjistri {...}, Datë 11.05.2009, lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Njohjes së Diplomave, sipas të cilit: “Mbështetur në nenin 37 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e

Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.24, datë 03.09.2007 “Për procedurat dhe kriteret e njohjes së diplomave dhe të certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë”, Komisioni i Njohjes, në mbledhjen e datës 11.05.2009, mbasi shqyrtoi dokumentet e z. {...}, vendosi: “Njohjen e Diplomës së Studimeve Pasuniversitare të z. {...} nga Universiteti {...}, me program 1–vjeçar në Studime të Evropës Juglindore, si Diplomë e Nivelit të Dytë”.

Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli ka vlerësuar se kandidati z. {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të “qenies jurist”, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës – Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Librezë Pune”, sipas të cilit kandidati ka përvojë profesionale si lektor i së drejtës dhe jurist i nivelit të lartë në administratën publike. Konkretisht, në mënyrë kronologjike, përvoja profesionale e kandidatit sipas dokumentit “Librezë Pune” është si vijon: “Pedagog” në Universiteti {...}, për periudhën 01.10.2009 – 31.08.2013; “Dekan i Fakultetit të Drejtësisë” në Universitetin {...}, për periudhën 06.10.2014 – 06.10.2015; “Pedagog ” në Universiteti {...}, për periudhën 30.10.2015–29.03.2018; “Komisioner Publik” në Institucionin {...}, për periudhën 30.03.2018 dhe në vijim.

Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht: me Shkresën nr. {...} prot., datë 24.10.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se “Për shtetasin {...} ... për efekt burim to ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Komisionerët Publikë - Komisioner Publik”. Bashkëlidhur kësaj shkrese është dërguar dhe një kopje – historiku i punësimit sipas {...}, kopje – ekstrakti historik i punonjësit, me të gjithë të dhënat shifrore të pagës, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributet përkatëse dhe TAP për çdo muaj, vit dhe subjekt/institucion punëdhënës, në të cilin ka punuar dhe/ose punon kandidati. Në historikun e punësimit sipas {...} pasqyrohet punësimi i kandidatit: – në {...}, për periudhën Tetor 2015 – Janar 2016; – në “{...}” për periudhën Tetor 2015 – Mars 2018,

si dhe në të njëjtin institucion arsimor për periudhën Maj 2018 – Gusht 2018; – në Kolegjin {...}, për periudhën Tetor 2014 – Tetor 2015; – në {...}, për periudhën Dhjetor 2011 – Gusht 2013; – në {...}, për periudhën Nëntor 2017 – Qershor 2018, si dhe në të njëjtin institucion për periudhën Nëntor 2018 – Qershor 2019.

Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidati {...} ka rezultuar të ketë përvojë profesionale deri në momentin e kandidimit si vijon: 10 vjet pedagog në Shqipëri, 3 vjet e 10 muaj asistent profesor në Universitetin {...}, si dhe 2 vjet Jurist.

Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli ka vlerësuar se kandidati z. {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të “pasjes së përvojës profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

c) pasja gradë shkencore në drejtësi – Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentin “Diplomë Doktorate”, lëshuar më datë 21.06.2011, nga Universiteti “National and Kapodistrian {...}, sipas të cilit “Z. {...} fiton Gradë Shkencore “Doktor” në “Shkenca Juridike”. Gjatë verifikimit, u kërkuar dhe u mor informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila, me Shkresën nr. 9451/1 prot., datë 21.10.2019, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se: “... Grada shkencore “Doktor” në “Shkenca Juridike” e fituar nga z. {...} më datë 21.06.2011 në Universitetin “{...}” rezulton të jetë njohur në Republikën e Shqipërisë bazuar në Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë nr. {...}, datë 24.04.2013 dhe figuron e regjistruar në regjistrin për Gradën Shkencore dhe titujt akademikë të mbrojtur jashtë vendit me nr. rendor {...}. Nga sa rezulton nga verifikimi, Këshilli ka vlerësuar se kandidati z. {...} plotëson kushtin e kandidimit/emërimit atë të “pasjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit për Statusin.

ç) mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit – Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 26.09.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjesisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”. Nga

informacionet e marra nuk identifikohet ndonjë e dhënë sipas të cilës të verifikohet që kandidati të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit – Për këtë kusht kandidimi/emërimi është administruar një deklaratë me shkrim e 26.09.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjesisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”. Po ashtu, është kërkuar dhe është marrë informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. {...} prot., datë 28.10.2019, sa i përket kandidatit {...}, ka informuar se “nuk rezulton të ketë qenë pjesë e organeve drejtuese të partive politike”. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk ka rezultuar që kandidati të ketë qenë pjesë e organeve drejtuese të partive politike.

Kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, që përcaktohen nga ligji si kritere zgjedhshmërie, sipas shkronjës “a”, pika 1, të nenit 66 (titulluar “Pazgjedhshmëria dhe papajtueshmëria”), të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohen në këtë ligj (Ligjin 96/2016), konkretisht në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

Në nenin 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji; ...”.

Ndërsa në nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- a) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- b) është shtetas shqiptar;

...;

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

...;

e) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i këtyre kritereve të kandidimit/emërimit:

a) zotësia e plotë për të vepruar - Për këtë kriter është mbajtur në konsideratë se, referuar moshës së kandidatit, ai ka fituar zotësinë juridike, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa nuk rezulton që ajo t’i jetë hequr apo kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) shtetësia shqiptare; Po i kaloj këto kriteret formale.

c) gjendja gjyqësore - Për këtë kriter, kandidati ka depozituar vërtetimin e gjendjes gjyqësore, ku figuron i padënuar penalisht.

ç) disiplina në punë - Për këtë kriter, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore”. Po ashtu, është administruar dhe dokumenti “Librezë Pune”, në të cilën, në rubrikën “Shkaku i largimit nga puna”, nuk pasqyrohet në asnjë rast që kandidati të jetë larguar nga puna për shkaqe disiplinore. Nga ana tjetër, është kërkuar dhe është marrë informacion nga të gjithë subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidati ka punuar dhe punon aktualisht. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk rezulton që kandidati të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore apo që ndaj tij të jetë marrë dhe të ketë masë disiplinore në fuqi;

d) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990 – Për këtë kriter kandidimi, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit

1990”. Gjatë verifikimit, në kushtet kur kandidati z. {...} është i vitlindjes 1979, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të Vendimit 75/2019, atij nuk iu kërkua plotësimi dhe dorëzimi i formularit të aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, për sa kohë referuar vitlindjes së kandidatit ai nuk mund të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990. Këshilli ka vlerësuar se kandidati z. {...} plotëson kriterin e kandidimit, atë të “mosqenies anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990”.

dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete – Për këtë kriter, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim më datë 26.09.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se “nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”. Po ashtu, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, është kërkuar dhe është marrë informacion nga organet ligjzbatuese sipas pikës 2, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas të dhënave të grumbulluara, nuk rezulton që kandidati të ketë qenë apo të jetë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Procedura e kandidimit –

Bazuar në pikën 1, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit 102/2019, menjëherë pas kualifikimit të kandidatit për pozicionin në fushën të drejtës civile, me Vendimin nr. 262, datë 13.11.2019, “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Dritan Hallunaj si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”.

Në kushtet kur vetëm një prej kandidatëve konkurrent është kualifikuar në fazën e parë të procesit të kandidimit, pra atë të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, procedura e përzgjedhjes për emërim si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), pra faza e dytë e procesit të kandidimit, ka vijuar vetëm për këtë kandidat, konkretisht z. {...}.

Në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Vendimit 102/2019 dhe Metodologjisë së Vlerësimit dhe Pikëzimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.102, datë 25.03.2022, miratoi vlerësimin dhe pikëzimin paraprak për kandidatin z. {...}. Sipas këtij vendimi, kandidati është vlerësuar dhe pikëzuar paraprakisht në total me 85 pikë, nga 100 pikë të mundshme.

Në vijim të procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, pas vlerësimit dhe pikëzimit paraprak, edhe pse z. {...} ishte kandidati i vetëm në procedurën e përzgjedhjes, në zbatim të pikës 7, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sikundër dhe Vendimit të tij 102/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi me kandidatin një intervistë, në një seancë publike, më datë 25.03.2022.

Pas intervistës me kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vijoi shqyrtimin dhe vendosi në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin përfundimtar të kandidatit për secilën kategori të meritave, kriter, nënkriter dhe tregues, të përcaktuar në pikën 6, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të detajuar më tej në Vendimin 102/2019, plotësuar me shpjegimet përkatëse të të dhënave metodologjike me Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit. Kështu, me vendimin nr. 103, datë 25.03.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor e vlerësoi përfundimisht kandidatin z. {...} me 85 pikë, nga 100 pikët e mundshme.

Duke vlerësuar të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera deri më tani për kandidatin e vetëm të kësaj procedure, z. {...}, sikundër edhe dokumentacionin e

grumbulluar për procesin e kualifikimit dhe të vlerësimit, relatori ia parashtrori çështjen Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Në mbledhjen e datës 29.03.2022, duke konsideruar të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera deri më tani për kandidatin e vetëm të mbetur në garë të kësaj procedure, z. {...}, sikundër edhe dokumentacionin e grumbulluar për procesin e kualifikimit dhe të vlerësimit në procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr.172, datë 11.09.2019, bazuar në pikat 7 dhe 11, Seksioni D, Kreu VI, të vendimit të tij 102/2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për miratimin e projektvendimit për “Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. Z. {...}”.

Pasi të miratohet kjo, do të vijohet me pjesën tjetër që ka të bëjë me propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë (nëse do të kalojë propozimi i këtij Komisioni).

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Hallunaj për relatimin e plotë të projekt – akteve.

Kështu siç propozoni ju, kalojmë fillimisht në votim projekt–aktin të parë, që ka të bëjë me miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me propozimin nga ana juaj që në vendin e parë është zoti {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e dytë që ka të bëjë lidhur me propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatit z. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e shtata në rendin e ditës.

9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhënieve me Jashtë.*
2. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

(Futen në platformën “online” zoti Toro dhe zonja Luli, të cilët nuk morën pjesë në trajtimin e çështjes pararendëse.)

Naureda Llagami: Kalojmë me projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatores znj. Marçela Shehu.

Duhet të ftojme edhe dy kolegët e tjerë për t’u përfshirë “online”.

Klodi të lutem, bëjmë të mundur.

Atëherë, mund të vazhdosh Marçela me renditjen për pozicionin 396.

Marçela Shehu: Siç e cituat edhe ju zonja Kryetare, me cilësinë e relatores, si dhe me konfirmim nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i është paraqitur sot për shqyrtim mbledhjes plenare, projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka hapur disa procedura ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndër të tjera, edhe për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës penale, pozicione këto të shpallura respektivisht me vendimet e Këshillit nr. 184, nr. 185, datë 28.05.2020 dhe nr. 396, datë 07.10.2020.

Projektvendimi i paraqitur sot lidhet me pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, ndaj unë do të ndalem vetëm në detaje vetëm me kandidatët që lidhen pikërisht me këtë pozicion.

Me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020 kanë kandiduar fillimisht 4 kandidatë, konkretisht: gjyqtarja znj. {...}, kandidatja tjetër gjyqtarja znj. {...}, gjyqtarja {...} dhe gjyqtarja znj. {...}.

Nga këta katër kandidatë rezulton se zonja {...} është tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396, shkak për të cilin Këshilli me vendimin nr. 110, datë 25.03.2022 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Gjithashtu, kandidatja {...} është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion dhe Këshilli, me vendimin nr. 350, datë 09.09.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Gjithashtu, edhe zonja {...} është tërhequr nga kandidimi për këtë pozicion dhe Këshilli, me vendimin nr. 302, datë 13.07.2021 ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Pra, siç konstatohet, kandidatë e vetme e mbetur në këtë procedurë për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit, është kandidatja gjyqtarja zonja {...}.

Për këtë kandidatë është realizuar procedura e verifikimit të kriterëve formale ligjore dhe më pas verifikimi i pasurisë dhe figurës dhe me vendimin nr. 525, datë

10.11.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasi është konkluduar se kjo kandidatë i plotëson të gjitha kriteret që kërkon ligji lidhur me kandidimin e saj në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ndërkohë, në respektim të kriterëve ligjore është realizuar edhe procesi i vlerësimit etik dhe profesional për këtë kandidatë. Kështu, për kandidaten janë administruar dy vlerësime etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 67, datë 23.02.2022 dhe nr. 33, datë 26.01.2022 vendime të cilët janë përfundimtarë, për sa kohë ndaj tyre nuk është paraqitur ankim nga gjyqtarja.

Lidhur me vlerësimet profesionale dhe etike:

a) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 67, datë 23.02.2022, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 388 pikë;

b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 33, datë 26.01.2022, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 392 pikë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, siç e cituam edhe më sipër, tashmë ka vetëm një kandidat dhe për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive, sipas përcaktimeve të Kreut IV, të vendimit nr. 70/2020 në funksion të renditjes së kandidatëve.

Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të vendimit nr. 70/2020, me cilësinë e relatores kam përgatitur projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë, në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396 datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, rezulton si më poshtë: 1) Znj. {...}.

Kandidatja e vetme si më lart, në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 396, zonja {...}, kishte kandiduar edhe për pozicione të tjera në gjykatën e apelit, por gjatë procedurës së

përzgjedhjes, kandidatja ka depozituar një kërkesë në Këshill, protokolluar me aktin nr. {...} prot., datë 03.03.2022, duke renditur si preferencë të parë, kandidimin e saj në fushën e së drejtës penale për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 396 datë 07.10.2020, të Këshillit, pra pikërisht për këtë procedurë ngritjeje në detyrë, për të cilën është përgatitur edhe projektvendimi i cili është paraqitur sot për shqyrtim mbledhjes plenare.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshilli i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 396 datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Znj. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Kryetare, ky është projektvendimi, i cili paraqitet sot për shqyrtim dhe për miratim mbledhjes plenare.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Shehu!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, që të votojmë projekt-aktin sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

6.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

6.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta në rendin e ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

6.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

6.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë me projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 394, datë

07.10.2020; dhe me vendim nr. 395, datë 07.10.2020. Të dy projekt-aktet do të relatohen nga zoti Toro.

Alban, për ty fjala.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të plotësimit të vakancave në sistemin gjyqësor, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka proceduar me hapjen e dy pozicioneve të lira në fushën e së drejtës civile, duke nisur procedurat për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në këto pozicione.

Për dy pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile të cituara më lart, kandiduan gjithsej 5 kandidatë, dhe konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}. Më pas një nga kandidatët është tërhequr dhe përfundimisht, në formë tabelare ju kam paraqitur kandidatët të cilët kanë vijuar konkurrimin për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020 ({...} dhe {...}), ndërkohë që për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020 ({...}, {...}, {...} dhe {...}).

Për të gjithë këto kandidatë, Këshilli ka proceduar me verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të parashikuar në nenet 8/3, 48/8, 47/4 të ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit” dhe më pas për zonjën {...}, me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020 ka proceduar me kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

Ndërkohë për zonjën {...}, me vendimin nr. 268, datë 28.06.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë;

Për zonjën {...} ka proceduar me vendimin nr. 204, datë 20.05.2021 duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të mëtejshme.

Për zonjën {...}, me vendimin nr. 525, datë 10.11.2021, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Për zotin {...}, me vendimin nr. 267, datë 28.06.2021, ka vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë.

Më tej, nga ana e Këshillit është proceduar edhe me procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, duke pasur në konsideratë vlerësimin me qëllim gradimi, për periudhën e

vlerësimit 2013–2016, si dhe vlerësimin e përshpejtuar të vitit 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019.

Në këtë kuadër, me qëllim pikëzimin e tyre, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, duke administruar gjithashtu edhe vlerësimet e tyre respektive të kryera, me qëllim të formalizimit të procedurave të ngritjes në detyrë.

Për kandidaten {...}, u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale, të miratuara me vendimet nr. 515 dhe nr. 516, datë 03.11.2021, vendime të cilat janë përfundimtare dhe të formës së prerë.

Ndërkohë, për zonjën {...}, u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale, të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 33, datë 26.01.2022 dhe nr. 67, datë 23.02.2022, vendime të formës së prerë.

Për zonjën {...}, u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 397 dhe nr. 398, datë 22.09.2021, vendime të formës së prerë.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet nr. 533 dhe nr. 534, datë 17.11.2021, vendime të formës së prerë.

Për kandidatin z. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 419 dhe nr. 420, datë 29.09.2021, vendime të formës së prerë.

Në procedurën e përzgjedhjes në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020 u përfshinë 3 kandidatë, konkretisht: znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}. Kjo e fundit më pas është tërhequr nga kandidimi në fazën e përzgjedhjes, duke ngelur vetëm dy kandidatë për vijimin e mëtejshëm të procedurës.

Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B, Kreu IV, të Vendimit 70/2020.

Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, për kandidatët u konstatua:

Për znj {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 515, datë 03.11.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 516, datë 03.11.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

b) Për znj. {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 397, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar/graduuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Sipas Vendimit të Këshillit nr. 398, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...} dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i kanë “Shkëlqyeshëm” (të dyja kandidatet).

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelit të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për kandidatët me rezultate të njëjta më të larta, pra znj. {...} dhe znj. {...}, u konstatua që ato kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “Shkëlqyeshëm”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, pra për atë të vitit 2019. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e këtyre dy kandidatëve sipas kësaj përparësie.

Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, u konstatua se një nga kandidatët me rezultate të njëjta më të larta, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë, ka përvoja të tilla. Konkretisht, u konstatua se gjyqtarja {...} ka përvojë si gjyqtare e komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, referuar për këtë vendimit nr. 297/7, datë 15.11.2012, të ish–Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin kandidatja është lejuar të shërbejë për një afat 3–vjeçar, si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, ndërkohë pas përfundim të afatit komandimit, ajo rikthehej në pozicionin e mëparshëm, atë të gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nisur nga përcaktimet pikave 8 dhe 15/b, të Vendimit 70/2020, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë arrihet

të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020, konkretisht si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...}.

Në këtë kuadër është përgatitur edhe projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Alban!

Atëherë, kalojmë me projekt-aktin e parë që ka të bëjë me miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit Tiranë. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë Alban?

Alban Toro: Po vijoj.

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 395, datë 07.10.2020, u përfshinë katër kandidatë, siç thashë edhe më parë, konkretisht: znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Për këta kandidatë, u verifikua plotësimi i kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës dhe u procedua më tej.

Edhe në këtë procedurë përzgjedhjeje, për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 48, pika 9, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimit 70/2020.

Referuar kriterit të parë të renditjes, atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, u administruan:

Për znj. {...} – vendimi i Këshillit nr. 67, datë 23.02.2022, periudha e vlerësimit 2013–2016, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”; vendimi nr. 33, datë 26.01.2022, për vlerësimin e vitit 2017–2019, niveli i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”;

Për znj. {...} – Vendimi i Këshillit nr. 533, datë 17.11.2021, për vitet 2013–2016, niveli i përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”; Vendimi nr. 534, datë 17.11.2021, për vitin 2019, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”.

Për znj. {...} - Vendimi i Këshillit nr. 397, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2013–2016, “Shkëlqyeshëm”; ndërkohë që me vendimin e Këshillit nr. 398, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për vitin 2019, “Shkëlqyeshëm”.

Për z. {...} – Vendimi i Këshillit nr. 419, datë 29.09.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2013–2016, “Shkëlqyeshëm”; me vendimin e Këshillit nr. 420, datë 29.09.2021, për vitin 2019, kandidati është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që të katër kandidatët, konkretisht znj. {...}; znj. {...}; znj. {...} dhe z {...}, të kenë “Shkëlqyeshëm” të dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale.

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelit të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart u parashtrua, për kandidatët me rezultate të njëjta më të larta, pra znj. {...}; znj. {...}; znj. {...} dhe z {...}, u konstatua që ata kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “Shkëlqyeshëm”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, pra për atë të vitit 2019. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e kandidatëve sipas kësaj përparësie.

Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, u konstatua se asnjë nga të katër kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, nuk ka përvoja të tilla. Për pasojë, kjo përparësi është e pa aplikueshme për renditjen e kandidatëve në këtë rast.

Referuar nën-përparësive të përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra atyre sipas “kohëzgjatjes së përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” dhe “shumëllojshmërisë së përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit”, në kushtet kur

asnjë nga kandidatët nuk ka përvoja të tilla, edhe ky kriter është i paaplikueshëm në rastin konkret.

Kështu që kaluam tek përparësia e tretë për kriterin e parë të renditjes, asaj sipas “skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”, ku për katër kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, u konstatua dhe u bë një renditje në bazë të skemës së pikëve të miratuara nga ana e Këshillit dhe nga pikët e grumbulluara renditja përcaktohet si e tillë:

Zonja {...} – 780 pikë në total;

Zonja {...} – 757 pikë në total;

Zonja {...} – 785 pikë në total;

Zoti {...} – 775 pikë në total.

Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 395, datë 07.10.2020 rezulton si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...};

3) Z. {...};

4) Znj. {...}.

Edhe kandidatja e renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 395, datë 07.10.2020, pra znj. {...}, pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që në momentin e kandidimit, ka shprehur preferenca kandidimi, sikurse përcaktohet në pikën 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin. Për pasojë, për këtë kandidate është e zbatuar preferenca e kandidimit sipas se cilës si preference të parë ishte pozicioni i lirë në fushën e të drejtës civile i shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020.

Në këtë kuadër u përgatit projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Toro!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim mbi përmbajtjen e projekt-aktit, të kalojmë në procesin e votimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Z. {...};
4. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).⁴

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta në rendin e ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit z. Dritan Hallunaj.

Dritan Hallunaj: Faleminderit, Kryetare!

Është përgatitur relacioni nga ana ime dhe është kaluar në Komision projektvendimi mbi renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021.

Pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor, në kuadër të plotësimit të pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli ka hapur disa procedura ngritjeje në detyrë, ndër të tjera, edhe për një pozicion të lirë, me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të hapur me këtë vendim, ka aplikuar kandidati, z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier por aktualisht i komanduar si gjyqtar i skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë nga data 05.11.2020 e në vijim.

Në vijim janë kryer procedurat për ngritjen në detyrë duke bërë renditjen për kandidatët që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësimit në rastin konkret për të vetmin kandidat, të kriterëve të më poshtme:

1) “përvojës profesionale minimale”, sipas shkronjës “b”, pika 2, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale: ...; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; ...”;

2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”: “8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”;

3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”: “1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, etj...”

4) “dhënies së pëlqimit (ai/ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku thuhet që: “4. ... Kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, ..., si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake...”; “3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligj...”; gjithashtu në zbatim të Ligjit nr.95/2016, përcaktohet se: “1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë ... në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ... firmosin deklaratën përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi... Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen. Etj.”

5) të pasurisë dhe figurës, ku thuhet që: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji”, si dhe: “8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

Kështu, për kandidatin e vetëm, z. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ai të kriterëve të kandidimit dhe me vendimin nr. 570, datë 07.12.2021, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar.

Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidatin kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin; 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”. Kryerja e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin në këtë rast, përveç se një detyrim ligjor, ndërsa ai nuk kishte asnjë vlerësim të tillë, është vlerësuar e domosdoshme për sa kohë ai kandidonte për ngritjen në detyrë në një gjykatë të specializuar, ku një vlerësim në nivelin e përgjithshëm “i pamjaftueshëm”, pra një vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët, jo vetëm nuk do të përlligjte ngritjen në detyrë, por, përkundrazi, referuar pikës 6, të nenit 95, të Ligjit për Statusin, do të përbënte shkas për dërgimin e raportit të

vlerësimin Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vlerësuar fillimin e hetimit dhe, më tej, të procedimit disiplinor ndaj kandidatit, duke vënë kështu në diskutim nga ana tjetër, plotësimin e kriterëve të kandidimit prej tij. Një rrethanë e tillë në rastin konkret lidhet veçanërisht me vlerësimin e përshpejtuar të kandidatit për vitin 2019, ndërsa sa i përkiste vlerësimin me qëllim gradimin për periudhën e rivlerësimit kalimtar, një moment i tillë është i tejkaluar sa kohë kandidati ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, çka, referuar përcaktimit të shkronjës “c”, pika 1, të nenit 59, të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, presupozon se kandidati ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, pra se ai është vlerësuar “I aftë”, pra që ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe se ka qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme përgjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në shkronjën “a”, të nenit 44, të këtij ligji.

Me kualifikimin e kandidatit z. {...}, bazuar në pikën 24, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli, me Vendimin nr. 15, datë 17.01.2022, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e tij nr. 30, datë 25.01.2021. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Dritan Hallunaj.

Më datë 17.01.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit 70/2020, kandidati i kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës, ku ai nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesë për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit 70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidatit, që gjendej në dosjen e tij personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësimin të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për të.

10. Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatin e vetëm z. {...} u konstatua se:

a) Sipas vendimit të Këshillit nr. 68, datë 23.02.2022, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 387 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim;

b) Sipas vendimit të Këshillit nr. 46, datë 08.02.2022, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, duke grumbulluar në total 398 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatit z. {...} të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 46, datë 08.02.2022 dhe nr. 68, datë 23.02.2022, u konstatua të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim. Lidhur me këtë, konstatohet se vendimet si më lart të Këshillit i janë dërguar për njoftim kandidatit në adresën elektronike të paraqitur nga vetë, si dhe në rrugë postare, me shkresën përcjellëse nr. {...} prot., datë 14.02.2022 dhe shkresën nr. {...} prot., datë 25.02.2022. Ndërkohë, me anë të komunikimit elektronik të datës 25.02.2022 dhe datës 28.02.2022, kandidati z. Pëllumbi ka konfirmuar dakordësinë me dy vlerësimet, miratuar me vendimet e Këshillit nr. 68, datë 23.02.2022 dhe nr. 46, datë 08.02.2022.

Me shkresën protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 28.02.2022, z. Pëllumbi deklaroi heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 dhe atë të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021 të Këshillit. Në vijim, po përmes kësaj shkrese ai shpreh vullnetin për të vazhduar kandidimin vetëm për pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me vendimin nr. 30, datë 25.01.2021 të Këshillit. Lidhur me kërkesat për heqje dorë nga kandidimi, Këshilli me vendimin nr. 107, datë 25.03.2022 vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira, të shpallura me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 dhe nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.”

Sa më lart, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit, Këshillit i propozohet të miratojë renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1) Z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Së fundi, në projektvendimin paraparak përcaktohet se ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky projektvendim u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 29.03.2022, sikurse përcaktohet edhe në vendimin përkatës të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 70/2020, ku u konstatua si i plotë dokumentacioni i administruar për kandidatin në këtë procedurë, duke vendosur kalimin e çështjes në seancën plenare në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Hallunaj!

Atëherë, ftoj kolegët, pasi dëgjuam relatimin, nëse nuk kanë ndonjë koment ose diskutim, të kalojmë në procedurën e votimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 30, datë 25.01.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jastë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.

7. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Toro. Ndjesë, fjalën e ka zoti Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në ditën e sotshme, ndërmjet të tjerave, ka paraqitur projektvendimin dhe bashkëlidhur edhe relacionin përkatës që i referohet

fillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur projektvendimit, po parashtrojmë edhe relacionin përkatës:

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji dhe me miratimin edhe të Vendimit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në kohë të ndryshme, ka hapur disa procedura ngritjeje në detyrë të gjyqtarëve, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021.

Brenda afatit të kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 16.04.2021, kandidoi vetëm një kandidat, konkretisht gjyqtarja znj. {...}, gjyqtare e emëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, aktualisht e komanduar si Këshilltare ligjore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në procedurën e ngritjes në detyrë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, ka përfunduar procedura e verifikimit për kandidaten e vetme znj. {...}, për të cilën, Këshilli, me vendimin nr. 116, datë 29.03.2022, ndër të tjera, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për këtë kandidate po vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Sa më sipër, rezulton se në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.123, datë 01.04.2021, kandidatja e vetme znj. {...} është kualifikuar.

Në vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Kreun V, Seksioni A, titulluar “Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit”, pika 24, parashikohet se: “Këshilli, jo më vonë së 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Për arsye të motivuara, mbi kërkesën e çdo anëtari të

Komisionit, Këshilli mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti”. Ndërsa, në Kreun VI, Seksioni B, titulluar “Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit”, pika 45, parashikon se: “Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht: a) me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë; ...”.

Nga ana tjetër, në këtë akt nënligjor, Kreun III (“Përkufizime”), pika 7, shkronja “j”, përcaktohet se: “Procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”, nënkupton procesin administrativ të renditjes dhe përzgjedhjes, sipas rastit, kandidatin ose kandidatët e renditur më lart”. Më tej, në shkronjën “d”, të kësaj pike, përcaktohet se: “Komision”, nënkupton Komisionin e Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, që përbëhet nga tre anëtarë, anëtarët e përhershëm ose zëvendësues, duke ruajtur në çdo rast kompozimin e tij sipas pikës 10, neni 62, të Ligjit për Qeverisjen”. Ndërsa, në shkronjën “g”, të kësaj pike, përcaktohet se: “Relator”, nënkupton anëtarin e përhershëm ose zëvendësues të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, që zgjidhet me short për të realizuar një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë”.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sipas pikës 1 të tij, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, pikës 2, të tij, Këshilli do të duhet të caktojë relatorin për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pozicionin e lirë të përmendur më lart.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në këtë rast, ka vlerësuar se relatori i caktuar me vendim të Këshillit, për çështjet e përzgjedhjes lidhur me pozicionin e shpallur me vendimin nr. 125, datë 01.04.2021, do të duhet të caktohet relator edhe për procedurën e

përzgjedhjes që propozohet të fillohet sipas projektvendimit, pra për çështjet e përzgjedhjes për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, ne propozojmë që relatori të jetë z. Alban Toro. Kjo propozohet, duke mbajtur në konsideratë për këtë praktikën e ndjekur deri më sot për shpërndarjen e ngarkesës së punës, ku me synimin e administrimit sa më të mirë dhe më me efikasitet të këtij procesi si relator në procedurat e përzgjedhjes të filluara rishtazi është caktuar anëtari i Komisionit, që është caktuar përmes shortit, si relator për procedurat e tjera të përzgjedhjes të filluara më parë, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në të njëjtën gjykatë. Përrjashtim nga ky rregull i ndjekur kanë qenë rastet kur në një gjykatë ka pasur shumë pozicione të lira në proces, në më shumë se një fushë të së drejtës dhe me disa kandidatë për çdo pozicion. Në këto raste relatori është caktuar përmes shortit, sipas fushave të së drejtës për pozicionet e lira që kanë qenë në proces kandidimi. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e vendimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Klodi!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit, nëse nga kolegët nuk ka diskutime.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Naureda Llagami: Dritan!

Dritan Hallunaj: Dakord. *(Sipas konfirmimit të tij me e-mail, pasi nga audio nuk është bërë e mundur të dëgjohet vota. Për efekt dokumentimi, konfirmimi i votës me e-mail gjendet bashkëlidhur procesverbalit të sigluar).*

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Alban Toro, si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 123, datë 01.04.2021, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

9.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

- | | |
|---------------------------|------------------|
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

9.1 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

9.2 Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës që të bëjë edhe kjo me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin

nr. 179, datë 28.05.2020, dhe më tej me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020. Për të dyja këto projekt-akte, relator është zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në vijim të përpjekjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të plotësuar vakancat në Gjykatën e Apelit Tiranë, është proceduar për të hapur 5 pozicione të lira në fushën e së drejtën civile si dhe rrjedhimisht për fillimin e procedurave të ngritjes në detyrë, duke proceduar me vendimet nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182 dhe nr. 183, datë 28.05.2020.

Për këto pozicione kanë kandiduar përkatësisht zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zoti {...}, zonja {...}, zonja {...}, zonja {...} dhe zonja {...}.

Pas dorëheqjeve, në vijim të kandidimit të disa prej gjyqtarëve apo caktimit në pozicione të tjera të hapura në shkallë të tjera të sistemit gjyqësor apo mbylljes së pozicionit të hapur me vendimin nr. 180, nr. 182, datë 28.05.2020 për shkak sepse përfunduan procedurat dhe u caktuan gjyqtaret {...} dhe {...}, përfundimisht përfunduan kandidimet e gjashtë gjyqtarëve për tre pozicione të lira të shpallura në fushën e së drejtës civile, për ngritjen në detyrë, të cilët i kam paraqitur në formë tabelare dhe përkatësisht:

Për pozicionin, e shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020 kandidon {...}, {...} dhe {...}.

Për pozicionin, e shpallur me vendimin nr. 181, datë 28.05.2020: {...}, {...}, {...}.

Për pozicionin, e shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020: {...}, {...} dhe {...}.

Për të gjithë këta kandidatë, nga ana e Këshillit, kanë përfunduar procedurat e kritereve formale konform dispozitave, të nenit 8, pika 3; neni 47, pika 4; neni 48, pika 8, të ligjit për Statusin.

Më tej, kanë përfunduar edhe procedurat për kualifikimin e kritereve të tjera dhe përkatësisht për zonjën {...}, nga ana e Këshillit është proceduar me vendimin nr. 649, datë 29.12.2020, ku është vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë.

Për zonjën {...} është proceduar me vendimin nr. 101, datë 18.03.2021, ku është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të mëtejshme.

Për zonjën {...} është proceduar me vendimin nr. 651, datë 29.12.2020, duke vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për zonjën {...} është proceduar me vendimin nr. 499, datë 21.10.2020, duke u vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Për zonjën {...} është proceduar me vendimin nr. 205, datë 20.05.2021, duke vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurave të tjera.

Për zonjën {...} është proceduar me vendimin nr. 453, datë 19.10.2020, duke vendosur kualifikimin dhe vijimin e procedurave të tjera.

Krahas procedurave të verifikimit të kritereve të kandidimit, është proceduar njëkohësisht edhe me vlerësimet etike dhe profesionale, për vitet 2013–2016 si dhe për vitin 2019.

Në këtë kuadër, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare. Po ashtu, janë administruar edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar. Duhet përmendur se dy nga kandidatët, znj. {...} dhe znj. {...}, kanë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit dy vendimet e Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional të saj, referuar shkresës së Gjykatës Administrative të Apelit nr. {...} prot., datë 29.12.2021 dhe shkresës nr. {...} prot., datë 30.04.2021, në të cilat ka informuar në lidhje me ankimin. Gjithashtu vlen të theksojmë në lidhje me pozicion e lirë të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidaten e znj. {...} nuk ka përfunduar ende procedura e verifikimit për dy vlerësime etike dhe profesionale.

Në situatën e sipërcituar, konstatohet se procedura e përzgjedhjes, pra renditja e kandidatëve dhe përzgjedhja e kandidatit të renditur më lart me qëllim ngritjen e tij në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, mund të vijojë dhe të përmbillet vetëm sa i përket procedurave të ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 179 dhe nr. 181, datë 28.05.2020, në rrethanat kur vetëm për kandidatët e këtyre pozicioneve të lira ka përfunduar procedura e verifikimit dhe për ata ka dy vlerësime etike dhe profesionale. Në procedurën e ngelur të ngritjes në detyrë në

Gjykatën e Apelit Tiranë, pra për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 183, datë 28.05.2020, procedurat e përzgjedhjes nuk mund të përmbillen, për shkak se për një kandidat për të cilët nuk ka ende vendime të Këshillit për vlerësimin etik dhe profesional. Sipas pikës 46, të Vendimit 70/2020: “Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë”.

Vijimi i procedurave të përzgjedhjes në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 179 dhe nr. 181, datë 28.05.2020, nuk sjell implikim për kandidatët e këtij pozicioni, ndaj vlerësuar edhe emergjenca e plotësimit të pozicioneve të lira në këtë gjykatë, dikton përmbylljen sa më parë të këtyre procedurave.

Në këtë kuadër, është administruar plotësisht dokumentacioni i nevojshëm në funksion të përmbylljes së procedurave të përzgjedhjes sa i përket pozicioneve të lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 179 dhe nr. 181, datë 28.05.2020.

Për kandidaten znj. {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 382 dhe nr. 383, datë 22.09.2021 (të formës së prerë).

Për znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 297 dhe nr. 298, datë 13.07.2021 (vendime të formës së prerë).

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 153 dhe nr. 154, datë 14.04.2021. Të dyja këto vendime janë ankimuar dhe përfundimisht Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.3, datë 04.02.2022 dhe vendimin nr.7, datë 11.02.2022 ka lënë në fuqi vlerësimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për kandidaten znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet e Këshillit nr. 526 dhe nr. 527, datë 10.11.2021, vendime të formës së prerë.

Për znj. {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me vendimet nr. 557 dhe nr. 560, datë 01.02.2021, vendime të ankimuara dhe më pas të lëna në fuqi vlerësimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr.6, datë 11.02.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit, duke marrë përfundimisht formë të prerë.

Pas administrimit të dokumentacionit, në përputhje me Kreun IV (ku përcaktohen hapat e renditjes së kandidatëve), të vendimit 70/2020, është realizuar renditja e kandidatëve për secilin nga dy pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura nga Këshilli për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në lidhje me pozicionin e hapur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku u bazuam fillimisht te kriteri i parë i renditjes, pra niveli i dy vlerësimet të mëparshme etike dhe profesionale për këto kandidatë rezultojnë si më poshtë:

a) Për znj. {...} – Sipas Vendimit të Këshillit nr. 153, datë 14.04.2021, kandidatja, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 është vlerësuar “Shumë mirë”; Me Vendimin nr. 154, datë 14.04.2021, për vitin 2019 kandidatja është vlerësuar në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”;

b) Për znj. {...} – Me Vendimin e Këshillit nr. 297, datë 13.07.2021, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 kandidatja është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”; Me Vendimin nr. 298, datë 13.07.2021, kandidatja për vitin 2019 është vlerësuar në nivelin “Shumë mirë”.

c) Për znj. {...} – Me Vendimin e Këshillit nr. 382, datë 22.09.2021, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 kandidatja është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”; Me Vendimin e Këshillit nr. 383, datë 22.09.2021, për vitin 2019 kandidatja është vlerësuar “Shumë mirë”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që kandidatja znj. {...}, të ketë “Shumë mirë” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse znj. {...} dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i kanë “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohen dy kandidatë me rezultate të njëjta më të larta, konkretisht znj. {...} dhe znj. {...}, të cilat renditen më lart se znj. {...}. Por, nga ana tjetër, referuar këtij kriteri renditjeje, është e pamundur renditja e dy kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta, duke mos u arritur kështu përcaktimi i renditjes së plotë të kandidatëve, për të identifikuar kandidatin e

renditur më lart. Ndërkohë, për këtë procedurë përzgjedhjeje, mbetet e parëndësishme renditja e kandidatëve të tjerë me rezultate më të ulëta, ndërsa qëllimi i procedurës së përzgjedhjes është identifikimi i kandidatit me rezultatet më të larta.

Referuar përparësisë së parë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “nivelet të vlerësimit të fundit”, nisur nga sa më lart, për kandidatët me rezultate të njëjta më të larta, pra znj. {...} dhe znj. {...}, u konstatua që ato kanë të njëjtin nivel vlerësimi, “Shume mirë”, për vlerësimin e fundit etik dhe profesional, pra për atë të vitit 2019. Për pasojë, rezultoi e pamundur renditja e këtyre dy kandidatëve me këtë kriter.

Referuar përparësisë së dytë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit”, apo duke iu referuar edhe nënparësisë të përparësisë së dytë për kriterin e parë “kohëzgjatjes së përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit,...”, në kushtet kur mungon një eksperiencë e tillë, të dyja këto përparësi dhe nënparësi, nuk mund të merren në konsideratë për shkak se të dy kandidatët nuk gëzojnë një përvojë të tillë.

Kështu që kaluam tek përparësia e tretë për kriterin e parë të renditjes, pra “skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”, për dy kandidatët me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, të cilat paraqiten si më poshtë:

Sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 382, datë 22.09.2021, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 387 pikë; Sipas “Raportit të vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për vitin 2019”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 383, datë 22.09.2021, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 386 pikë; Në total, për të dy vlerësimet etike dhe profesionale, kandidati është vlerësuar me 773 pikë;

Për znj. {...} – Sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013–2016”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 297, datë 13.07.2021, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 379 pikë; Sipas “Raportit të vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të kësaj gjyqtareje, për vitin 2019”, miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 298,

datë 13.07.2021, për të 4 kriteret e vlerësimit, kandidatja është vlerësuar në total me 371 pikë; Në total, për të dy vlerësimet etike dhe profesionale, kandidatja ka marrë 750 pikë;

Nga zbatimi i përparësisë së tretë për kriterin e parë të renditjes, pra asaj sipas “skemës së pikëve të miratuar nga Këshilli”, bëhet e mundur renditja e dy kandidatëve me rezultate, nivele të njëjta vlerësimi etik dhe profesional, si më poshtë:

- 1) Znj. {...} -773 pikë;
- 2) Znj. {...} - 750 pikë;

Përfundimisht, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 179, datë 28.05.2022, rezulton si më poshtë:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...} dhe {...}.

Përfundimisht, nga ana e relatorit është përgatitur edhe projektvendimi në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni si më poshtë:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Toro!

Atëherë, ftoj kolegët nëse nuk kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, të kalojmë në procesin e votimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 179, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Znj. {...};

3. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për

Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04...

Alban Toro: Më fal.

Mos duhet të vijojmë edhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 181?

Naureda Llagami: Po!

Ke të drejtë.

Ndjësë!

Kalojmë tek renditja për pozicionin sipas vendimit nr. 181, datë 28.05.2020.

Prapë relator z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 181, datë 28.05.2020 u përfshinë 3 kandidatë, konkretisht zonja {...}, zonja {...} dhe zonja {...}.

Po për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të renditjes për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurat e ngritjes në detyrë, ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale.

Natyrshëm edhe për ta, u fillua me kriterin e parë të renditjes sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, nga e cila rezulton se:

a) Për znj. {...} – Në bazë të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 382, datë 22.09.2021, kandidatja është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, “Shkëlqyeshëm”; Me Vendimin e Këshillit nr. 383, datë 22.09.2021, për vitin 2019, kandidatja është vlerësuar “Shumë mirë”;

b) Për znj. {...} - Sipas Vendimit të Këshillit nr. 557, datë 01.12.2021, për vitet 2013–2016, kandidatja është vlerësuar, në nivelin “Shumë mirë”; Me Vendimin e Këshillit nr. 560, datë 01.12.2021, për vitin 2019, kandidatja është vlerësuar “Shumë mirë”.

c) Për znj. {...} – Në bazë të Vendimit të Këshillit nr. 526, datë 10.11.2021, për vitet 2013–2016, kandidatja është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”; Në bazë të Vendimit të Këshillit nr. 560, datë 01.12.2021, për vitin 2019, kandidatja është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”.

Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, rezultoi që një kandidate, konkretisht znj. {...} të ketë “Shkëlqyeshëm” të dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kurse kandidatja znj. {...} dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “Shkëlqyeshëm” dhe “Shumë mirë dhe znj. {...}, dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i kanë “Shumë mirë” dhe “Shumë mirë”. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin, identifikohet një kandidate me rezultate më të larta, konkretisht kandidatja znj. {...}, e cila renditet më lart se kandidatet znj. {...} dhe znj. {...}.

Nisur nga përcaktimet e Vendimit 70/2020, ndërsa nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”, arrihet të identifikohet kandidati me rezultatet më të larta, pikërisht znj. {...}. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 181, datë 28.05.2020, nga e cila rezulton:

- 1) Znj. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Znj. {...}.

Në këto kushte, relatori, në përfundim, përgatiti draftin e vendimit, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};
2. Znj. {...};
3. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Alban!

Atëherë, kalojmë edhe një herë në procedurën e votimit për aktin e dytë që ka të bëjë me renditjen e kandidatëve të procedurës së ngritjes në detyrë sipas vendimit nr. 181, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Znj. {...};

2. Znj. {...};

3. Znj. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jastë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.

7. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek akti që përmenda më parë, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 117 dhe nr. 118, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Po parashtroj relacionin e radhës që ka për objekt miratimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme

të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji dhe me Vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në kohë të ndryshme, ka hapur disa procedura ngritjeje në detyrë të gjyqtarëve, ndër të tjera, edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021.

Brenda afatit të kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 16.04.2021, kandidoi vetëm një kandidat, konkretisht gjyqtarja znj. {...}.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, me vendimin nr. 178, datë 29.04.2021, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten e vetme znj. {...}, duke caktuar dhe relatorin përkatës.

Në procedurat e ngritjes në detyrë të shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, ka përfunduar edhe procedura e verifikimit për kandidaten e vetme znj. {...}, për të cilën, Këshilli, me vendimin nr. 117, datë 29.03.2022, ndër të tjera, ka vendosur kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Për këtë kandidate po vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional.

Sa më sipër, rezulton se në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, kandidatja e vetme znj. {...} është kualifikuar.

Ndaj sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatiti projektvendimin “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Nëpërmjet këtij projektvendimi, sipas pikës 1 të tij, Këshillit i propozohet të vendosë fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të

shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Po ashtu, sipas këtij projektvendimi, pikës 2, të tij, Këshilli duhet të caktojë relatorin për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pozicionet e lira të përmendura më lart.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në këtë rast ka vlerësuar se relatori i caktuar me vendim të Këshillit, për çështjet e përzgjedhjes lidhur me pozicionin e shpallur me vendimin nr. 119, datë 01.04.2021, do të duhet të caktohet relator edhe për procedurën e përzgjedhjes që propozohet të fillohet sipas projektvendimit, pra për çështjet e përzgjedhjes për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, relatori, sipas propozimit tonë, duhet të jem unë. Duke mbajtur në konsideratë për këtë edhe praktikën e ndjekur deri më sot për shpërndarjen e ngarkesës së punës, ku me synimin e administrimit sa më të mirë dhe më me efikasitet të këtij procesi si relator në procedurat e përzgjedhjes të filluara rishtazi është caktuar anëtari i Komisionit, që është caktuar përmes shortit, si relator për procedurat e tjera të përzgjedhjes të filluara më parë, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë në të njëjtën gjykatë. Përrjashtim nga ky rregull i ndjekur kanë qenë rastet kur në një gjykatë ka pasur shumë pozicione të lira në proces, në më shumë se një fushë të së drejtës dhe me disa kandidatë për çdo pozicion. Në këto raste relatori është caktuar përmes shortit, sipas fushave të së drejtës së pozicioneve të lira në proces. Rasti në shqyrtim nuk është i tillë.

Së fundi, në projektvendim parashikohet dhe momenti i hyrjes së tij në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin e vendimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim, të kalojmë në procesin e vendimmarrjes.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e z. Klodian Kurushi, si relator të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, për të dy pozicionet e shpallura me vendimet nr. 117 dhe nr. 118, datë 01.04.2021, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jasthtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.

7. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë lidhur me renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zotit Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Më lart cituam përpjekjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të plotësuar vakancat në sistemin gjyqësor, në Gjykatën e Apelit Tiranë, por njëkohësisht janë vijuar edhe procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për dy pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 187, nr. 188, datë 28.05.2020.

Në procedurat e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit për dy pozicione të lira si më lart, brenda afatit të kandidimit konkurrues gjithsej 5 kandidatë: znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Në vijim të procedurës së verifikimit, me vendimin e datës 02.09.2020 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vendosi kalimin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të relacionit dhe projektvendimit për “Verifikimin e plotësimit nga kandidatët të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020 të Këshillit”, por në Mbledhjen Plenare të datës 10.09.2020, pika 2 e rendit të ditës është vendosur shtyrja e vendimmarrjes për shkak se me vendimet 187 dhe 188 të datës 28.05.2020, Këshilli kishte shpallur dy pozicione të lira për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë. Në vijim, në një nga këto pozicione është caktuar z. {...}, i cili ka filluar ushtrimin e funksionit dhe një nga këto pozicione nuk ishte më e lirë. Rezulton se në mbledhjen plenare të datës 07.10.2020, Këshilli ka miratuar edhe Vendimin nr. 398, “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Kandidimi i gjyqtarit {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188, datë 28.05.2020, konsiderohet si kandidim në procedurën e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim iu është njoftuar gjyqtarëve të cilët kishin kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, përkatësisht znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

Ndërkohë, disa nga kandidatët për ngritjen në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pozicionet e lira si më lart rikonsideruan kandidimet e tyre. Kështu: Z. {...}, më datë 03.07.2020, tërhoqi kandidimet për të dy pozicionet e lira, shkak për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor procedoi me Vendimin nr.238/7, datë 07.07.2020, ku u vendos mosfillimi i procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit; Z. {...}, më datë 03.07.2020, tërhoqi kandidimin për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.188, datë 28.05.2020, shkak për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin

nr.{...}, datë 07.07.2020, vendosi mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit; Znj. {...}, më datë 04.08.2020, tërhoqi kandidimin për njërin nga dy pozicionet e lira, pa përcaktuar specifikisht atë, por duke përcaktuar se vijonte kandidimin për atë pozicion të lirë për të cilin do të vijonte procedura e ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Pra për pozicionin nr.187, datë 28.05.2020 vijuan këta kandidatë përfundimisht: z.{...}, z.{...}, znj.{...} dhe z.{...}.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatën Administrative të apelit, për një pozicion të lirë, Këshilli realizoi dhe përfundoi procedurat e verifikimit të kriterëve formale të parashikuara nga neni 8/3, 47/4 dhe 48/8 dhe njëkohësisht dhe kriteret e tjera, të figurës dhe të pasurisë.

Për këta kandidatë u administruan këto vendime:

Për zotin {...} u administrua vendimi nr. 3, datë 08.01.2021, me anë të së cilit është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë.

Për zotin {...} është administruar vendimi nr. 570, datë 07.12.2021, ku është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të tjera.

Për zotin {...}, vendimi nr. 561, datë 13.11.2020, në të cilin është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurave të tjera.

Për zonzjën {...}, vendimi nr. 37, datë 26.01.2022, ku është vendosur kualifikimi i saj dhe vijimi i procedurave të ngritjes në detyrë për këto gjykata.

Krahas verifikimit të kriterëve të kandidimit, të cilat i cituam, njëkohësisht nga ana e Këshillit vijuan edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për vitet 2013–2016, si dhe 2019.

Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, nga ana e relatorit është administruar dokumentacioni përkatës për secilin kandidat të kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikat dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Gjithashtu janë administruar edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar.

Për zotin {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 196 dhe nr.197, datë 12.05.2021, vendime të formës së prerë.

Për kandidatin {...} u administruan edhe dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 359 dhe nr. 360, datë 14.09.2021, vendime të formës së prerë.

Për kandidatin {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 46, datë 08.02.2022 dhe nr. 68, datë 23.02.2022, vendime të formës së prerë.

Për zonjën {...} u administruan dy vlerësimet etike dhe profesionale të miratuara me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 42, datë 31.01.2022 dhe nr. 45, datë 08.02.2022, vendime të formës së prerë.

Ndërkohë, gjatë procedurave së përzgjedhjes, kandidati z. {...} paraqiti një kërkesë, protokolluar në Këshill me nr. {...} prot., datë 16.12.2021, nëpërmjet të cilës ka kërkuar tërheqjen nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit. Mbi këtë kërkesë, nga ana e Këshillit është procedurat me Vendimin nr. 34, datë 26.01.2022. Gjithashtu, z. {...} paraqiti një kërkesë, protokolluar me aktin nr. {...} prot., datë 28.02.2022, mbi të cilin ka parashtruar tërheqjen nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit. Edhe për këtë kërkesë, nga Këshilli është proceduar me Vendimin nr. 107, datë 25.03.2022. Ndërsa znj. {...}, e cila kishte kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020, për këtë të fundit, në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë, pikërisht në procedurën e përzgjedhjes, Këshilli, ndërsa ka miratuar renditjen e kandidatëve, me Vendimin nr. 57, datë 10.02.2022, ka vendosur që znj. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Me Dekretin nr. {...}, datë 16.02.2022, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka emëruar znj. {...} Gjyqtare të Gjykatës së Lartë. Nisur nga një rrethanë e tillë, kandidatja znj. {...} nuk mund të vijojë procedurat për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ngelet vetëm një kandidat, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kritereve dhe përparësive sipas përcaktimeve në vendimin

nr.70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Përfundimisht, nga ana e relatorit është përgatitur projektvendimi, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, të kalojmë në procedurën e votimit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
3. **Klodian Kurushi** (anëtar)
4. **Fatmira Luli** (anëtare)
5. **Irena Plaku** (anëtare)
6. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
7. **Ridvan Hado** (anëtar)
8. **Alban Toro** (anëtar)
9. **Brikena Ukperaj** (anëtare)
10. **Marçela Shehu** (anëtare)
11. **Yllka Rupa** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë”.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili është projekt-akti i parë në fakt që i vjen Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka të bëjë me miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë.

Siç jeni në dijeni, Qendra e Teknologjisë së Informacionit për sistemin e drejtësisë është një institucion i cili është i parashikuar në nenin 92 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj është parashikuar në vendimin nr. 972, datë 02.12.2020 lidhur me organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të kësaj qendre (QTI).

Gjithashtu qendra (QTI-ja) funksionon dhe ushtron funksionin përmes dy organeve vendimmarrëse, që është Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

Për Bordin Drejtues, nëse ju kujtohet, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor u propozuan tre gjyqtarë që përfaqësojnë gjyqësorin në këtë bord drejtues dhe më tej, ajo që parashikon VKM-ja është që Bordi Drejtues, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, miraton strukturën dhe organikën e qendrës (QTI) dhe kjo strukturë e miratuar nga bordi, i përcillet Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke qenë se pjesa e buxhetit të QTI-së është pranë

Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe jemi ne që vendosim lidhur me buxhetin dhe çështjet e strukturës.

Siç jeni në dijëni, ajo që kemi parashikuar edhe në pjesën e buxhetit dhe që është parashikuar edhe nga VKM-ja, në strukturën e kësaj qendre (QTI-së) do të jenë Drejtori Ekzekutiv dhe pesë specialistë. Ka një strukturë që besoj e keni parë dhe është bashkëlidhur.

Nga ana tjetër, po me ndryshimet e VKM-së për përcaktimin e pagave, janë parashikuar edhe kategoritë e pagave për sa i përket stafit dhe drejtorit., ku keni një mënyrë të detajuar se sa është paga, përfshirë si paga kryesore ashtu edhe shtesat për shkak të vështirësisë.

Pas miratimit nga ana e bordit, ky projekt-akt i është përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor; ka kaluar në Komisionin e Administrimit të Buxhetit dhe i kemi prezantuar mbledhjes plenare projekt-aktin në fjalë.

Nëse keni ndonjë pyetje?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e strukturës dhe organikës së qendrës (QTI-së)

Ilir Rusi: Dakord me strukturën dhe organikën

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

(Për shkak të një çështjeje teknike, vota e zonjës Llagami si dhe dispozitivi i lexuar mbi vendimin e miratuar pak më herët nga anëtarët nuk është dëgjuar. Vota e saj është shprehur nëpërmjet “chat”-it në platformën elektronike, në dritaren e mbledhjes përkatëse. Për efekt dokumentimi, bashkëlidhur procesverbalit të sigluar gjendet vota e zonjës Llagami (citohet): “Jam dakord me vendimin për strukturën e QTI, pasi u shkëputa”.

Pak më herët Këshilli vendosi:

1. Miratimin e strukturës dhe organikës së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, sipas propozimit miratuar me Vendimin nr. 2, datë 25.02.2022, “Për miratimin e propozimit të strukturës dhe organikës të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, të Bordit Drejtues.

2. Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë organizohet dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës paraqitur në lidhjen nr. 1 dhe lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.)

Naureda Llagami: Ndjesë, sepse unë shoh që qenkam shkëputur, ndërkohë që flisja.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Naureda Llagami | <i>(kryetare)</i> |
| 2. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 3. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 4. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Dritan Hallunaj | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 9. Brikena Ukperaj | <i>(anëtare)</i> |
| 10. Marçela Shehu | <i>(anëtare)</i> |
| 11. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
2. *Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
7. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

Naureda Llagami: Aktet e tjera kanë të bëjnë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e një anëtari për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun”.

Për sa i përket nevojave për miratimin e këtij akti, sikurse e dini, ka të bëjë me faktin që nga ana e Këshillit, në vitin 2019, me vendim ishte përcaktuar zoti Erjon Muharremaj i cili tashmë nuk është më pranë Këshillit (i ka mbaruar mandati si anëtar i Këshillit), dhe për këtë arsye është shumë e domosdoshme që nga ana e Këshillit të vlerësohet caktimi i një anëtari të ri, në qasje me nenin 91 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku ngarkohet Këshilli për të caktuar një anëtar që merret me detyrat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh edhe standardet që kemi vepruar, fillimisht propozimi duhet të jetë për një përfaqësues nga gjyqësori, kështu që në këtë kontekst, nëse nga ana juaj është dakordësia, mund të propozojmë zonjën Marçela Shehu.

Jeni dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e znj. Marçela Shehu, për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.04.2022)

Pika 14 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.293, datë 06.07.2021 të KLGJ-së “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit””.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:10 dhe mbaroi në orën 13:07.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Marrëdhëniet me Jashtë.*
- 2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 3. Baisa Sefa, Këshilltare pranë Kabinetit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Entela Dobi dhe Denisa Varfi, përfaqësueset të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Erjon Muharremaj, ish- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Valbona Bala, përfaqësues e USAID-it.*
- 7. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

14 shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.293, datë 06.07.2021 të KLGJ-së “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit””.

Naureda Llagami: Nga ana tjetër, duke pasur parasysh që një nga vendimmarrjet që kishte të bënte me personin e caktuar për marrëdhëniet me publikun, vendimi nr. 293, datë 06.07.2021, i cili ka të bëjë me ngritjen e grupit të punës për hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit, i propozoj Këshillit që të ndryshojmë këtë vendim, ku në vend të zotit Erjon Muharremaj të caktohet zonja Marçela Shehu.

Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi është parashikuar që ky grup pune, në kryerjen e analizës së kuadrit ligjor, do të asistohet në fakt nga Misioni EURALIUS V. Në eventualitetin që EURALIUS V ka përfunduar, unë do të propozoja që këtë togfjalësh “me Misionin EURALIUS V” ta zëvendësojmë “me projektet që asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor”, për t’i dhënë mundësi që ndoshta, jo EURALIUS V, mund të vijë me një emër tjetër, pra projektin që do të kemi këtu të atashuar pranë Këshillit, të asistojë grupin e punës.

Jeni dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Ndryshimin e pikës nr. 2 të vendimit nr.293, datë 06.07.2021 të KLGJ-së “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Udhëzuesit Standard të Shtypit”, si më poshtë:

Në vend të z. Erjon Muharremaj caktohet zj.Marçela Shehu.

Gjithashtu edhe ndryshimin e pikës 3, togfjalëshi “edhe me Misionin EURALIUS” ta zëvendësojmë “edhe me projektet që asistojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Punë të mbarë dhe faleminderit!

* * *

(Pika 14 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor